



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC**

Numri i lëndës: 2021:217853  
Datë: 19.07.2024  
Numri i dokumentit: 05958137

PPP.nr.10/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në lëndën përbarimore të kreditores V.V, nga Rahoveci, të cilën e përfaqëson Av. Sh.Z, nga Rahoveci, kundër debitorit Komuna e Rahovecit, për shkak të shujtave dhe pagës jubilarë, më 19.07.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

Propozimi i kreditores V.V, nga Rahoveci, i ushtruar pranë kësaj gjykate, kundër debitorit Komuna e Rahovecit, për shkak të shujtave dhe pagës jubilarë, **KONSIDEROHET E TËRHEQUR.**

Lënda si e kryer ti deponohet arkivit të gjykatës.

**A r s y e t i m**

Sipas propozimit të kreditores V.V nga Rahoveci, Përbaruesi Privat S.K në Prizren, me Urdhërin P.nr.218/2020, datë 10.09.2020, ka caktuar përbarimin në bazë të vendimit përbarues i dhënë në procedurë administrative - Vendimi i Inspektoratit të Punës në MPMS-IP-Gjakovë, nr. 641/2020 të datës 30.06.2020 dhe i ekzekutueshëm me datë 30.06.2020, kundër debitorit Komuna e Rahovecit, për shkak të shujtave dhe pagës jubilarë, në shumën e përgjithshme prej 1,338.00 €.

Përfaqësuesi i autorizuar i kreditores Av. Sh.Z, me parashtresë të veçantë prej datës 17.07.2024, e ka tërhequr propozimin për përbarim.

Andaj kjo gjykatë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 261 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Kosovës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke konstatuar se propozimi i kreditorëve është i tërhequr.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**  
PPP.nr.10/2024, datë 19.07.2024

B. Profesional  
Armond Qmega

Gj y q t a r i  
Betim Behluli

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa e veçantë.